

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -I- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 31 JANAR 2019**

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Abdullah Vojvoda, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Basri Menxhiqi, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Agim Bregaj.

Lutfi Bilalli dhe Sami Istrefi, anëtarë të kuvendit janë dorëhequr nga pozita e anëtarit të kuvendit, por procedura e zëvendësimit të këtyre pozitave nga ana e KQZ-së akoma nuk ka përfunduar.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës -z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës Besim Muzaqi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se në sallë janë prezent 32 anëtarë të kuvendit, shumicë kjo e mjaftueshme për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se kushtet e punës për punëtorët e administratës komunale, por edhe për vet anëtarët e kuvendit janë rënduar tej mase sidomos kohëve të fundit, pas fillimit të stinës së dimrit, ku mungesa e ngrohjes në objektin e komunës është duke e vështirësuar mbajtjen e orarit të punës. Pastaj vlerësoi se edhe përkundër faktit se janë ndarë mjetet për blerjen e një agregati prapëseprapë nuk kemi zgjidhje të kësaj problematike.

Mehmet Selaci, drejtor i DA-së - tha se është e vërtetë se gjendja me ngrohje në objektin e komunës është shumë e keqe, dhe për këtë më së tepërmi e pësojnë punëtorët e komunës. Tutje

njoftoi se ka bërë përpjekje të vazhdueshme për rregullimin e këtij problemi, ku janë sjellë edhe kompani private për mënjanimin e këtij defekti, por askush nuk ka qenë i gatshëm të ndërhyjë, përderisa projekti i përfunduar ndodhet nën garancion. Gjithashtu kompania që është marrë me rregullimin e objektit “Ad construction”, ka dërguar një email para dy dite, në ç’rast ka bërë thirrje që asnjë person që nuk është i autorizuar të mos ndërhyjë në këtë projekt. Si rezultat i kësaj kemi ardhur në këtë gjendje, por shpreson se me ndarjen e buxhetit prej 50,000.00 € do të bëhet një projekt për rregullimin e këtij defekti.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se këtë qeverisje në përmasa të gjera: LDK-VV-AKR-AAK-NISMA-LS dhe pastaj edhe bashkimi me dy të pavarur dikush e quante “Koalicioni lokal në Vushtrri, për interesa të ngushta dhe jo për qytetarët!”, dikush tjetër e quante “Humbësit e bashkuar”, e kam quajtur “Koalicion me shumë të panjohura”, dhe veprimet e tyre po më japin të drejtë. Shfaqja e një dukurie negative ka ndodhur në vitin e parë të qeverisjes: PUNËSIMI I PAKONTROLLUAR ME KONTRATA MBI VEPËR ANGAZHIMET ME MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA. Punësimi me Kontratë mbi Vepër (Kontratë për Shërbime të Veçanta), kontratë kjo e cila sipas Ligjit të Shërbimit Civil përdoret për ato raste kur komuna nuk ka kuadro profesionale apo kapacitete të resurseve njerëzore në kryerjen e shërbimeve për çështje të caktuara. Pikërisht në këto raste kërkohen ekspertë të fushave konkrete. Të nderuar anëtarë të kuvendit, Komuna e Vushtrrisë në vitin 2018 ka angazhuar shumë zyrtarë në kryerjen e punëve për periudhën më të gjatë se gjashtë muaj, por edhe pa procedura përkatëse të rekrutimit. Se a po bartet “sindromi” i Vetëvendosjes së Prishtinës në Vushtrri, kjo nuk do koment. Sipas një hulumtimi nga Demokracia Plus (D+), për angazhimin e personave me kontrata mbi vepër (për vitin 2018), del se prin Komuna e Prizrenit me 85 raste, pikërisht komuna me të cilën udhëheq subjekti politik në fjalë. Në komunën tonë ku pjesë e qeverisjes është Vetëvendosje, shihet që dominon sa i përket angazhimit me kontrata mbi vepër. Pse po e them Vetëvendosje, sepse nga pesë drejtori me të cilat udhëheq kjo parti politike, vetëm në drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, nuk ka të angazhuar me kontratë mbi vepër.

Katër drejtoritë tjera kanë me sa vijon:

Drejtoria për Administratë: (VV)

- 3 zyrtarë për gjendje civile dhe (6+6)
- 3 zyrtarë për shërbim me qytetarë (6+6)

Drejtoria për Shërbime Publike (VV)

- 6 Mirëmbajtës të hapësirave publike (6+6)

Drejtoria për EBPZHR (VV)

- 3 pylltarë dhe (6+6)
- 3 zyrtarë për digjitalizim (6+6)

Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport (VV)

- 1 Ciceron 6
- 5 Piktore për murale 6

Që të jemi të sinqertë, kjo praktikë ka funksionuar edhe në qeveritë e mëparshme, por” lulëzimin” e vet e njohu në këtë qeveri. Z. nënkryetar, shumica e të angazhuarve me kontrata mbi vepër kanë qenë pa procedura të rekrutimit, por personat vetëm janë marrë në punë pa asnjë procedurë. Shumica e tyre janë angazhuar në pozita të rregullta në shërbimin civil (çka është e ndaluar) dhe jo për punë specifike (për çka kërkohet me ligj). Shqetësimi tjetër është mosrealizimi i projekteve, të cilat kanë qenë të aprovuara nga Kuvendi Komunal për vitin e kaluar. Një shembull që ia vlen të përmendet është fshati Zhilivodë: Kodi i projektit 45583-ASFALTIMI I RRUGËVE NË ZHILIVODË, Kodi i projektit 46889- NDËRTIMI I KULLËS

SË UÇK-SË NË ZHILIVODË, Kodi i projektit 45302- ASFALTIMI I RRUGËS “MARTIRËT E DRUARIT”, Kodi i projektit 45279- NDËRTIMI I LAPIDARËVE.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit - kërkoi që të mbështetet familja e Erzen Hyseni, i cili humbi jetën tragjikisht në vendin e tij të punës, andaj kërkoi që familjes së tij t’i ofrohet ndihmë morale dhe materiale, apo punësimin e ndonjë anëtari të kësaj familjeje në institucionet lokale në Vushtrri.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se i pret me dashamirësi çdo vërejtje dhe kritikë ndaj qeverisë aktuale të komunës, dhe shtoi se tavani i të punësuarve në shërbimin civil duke përfshi edhe komunën tonë, është i përcaktuar, ndërsa volumi i punëve është i madh dhe ai rritet varësisht nga angazhimet dhe projektet. Tutje ai shtoi se është e pamundur që me stafin aktual të mbulohen të gjitha punët dhe për këtë ka pasur të angazhuar punëtorë me kontratë mbi vepër. Duke folur për procedurën njoftoi se asnjë punëtor nuk është punësuar pa i përfillur procedurat e rekrutimit dhe kjo është e saktë. Lidhur me ofrimin e ndihmës për familjen Hyseni e cila humbi djalin e tyre në mënyrë tragjike, vlerësoi se duhet të gjendet një formë ligjore për ofrimin e ndihmës.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - duke replikuar me nënkryetarin e komunës, ceku se në momentin e vazhdimit të kontratës mbi vepër është bërë shkelja, sepse vazhdimi është bërë pa procedurë, d.m.th ata kanë vazhduar të punojnë duke e ditur se kontrata ka afat vetëm për periudhën gjashtëmujore.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se nuk ka përmendur askush militantë politikë, por të gjithë të punësuarit me kontratë mbi vepër janë qytetarë të Kosovës dhe të Vushtrrisë, dhe të qenit në një parti politike, nuk ja mohon të drejtën dikujt apriori që të punësohet në institucione publike. Pastaj shtoi se para vazhdimit të këtyre kontratave, secila drejtori ka marrë opinionin e zyrës ligjore të komunës, dhe fundi nëse ka shkelje ligjore secili do t’i bartë përgjegjësitë për veprimet e veta.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e DKRS-së - njoftoi se në Drejtorinë e Kulturës, kanë qenë të punësuar 4 piktorë, që kanë pasur për detyrë pikturimin e disa muraleve, si dhe në kalanë e qytetit është punësuar me kontratë mbi veprën një ciceron. Ndërsa atyre nuk iu është vazhduar kontrata, ku aktualisht në drejtori nuk ka asnjë të punësuar me kontratë mbi vepër.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se asnjëherë nuk është marrë me të punësuarit me kontratë mbi vepër, por është i pakontestueshëm fakti se këto kontrata janë të kundërligjshme, por në anën tjetër arsyetimi i nënkryetarit se nuk kanë mundur t’i kryejnë punët me stafin aktual të komunës është i paqëndrueshëm, mandej fakti dhe arsyetimi se ekziston tavani i të punësuarve në shërbimin civil është i saktë, por është fakt se në administratën komunale ka pozita të lira për të cilat nuk është shpallur konkursi, kurse suficit buxhetor në kategorinë e pagave janë humbur hiç më pak se 273,000.00 €, për faktin se nuk i ka shpallur pozitat në stafin civil të komunës, në mënyrë të rregullt, ligjore dhe transparente, këto janë fakte determinuese dhe të pakontestueshme.

Besim Muzaqi, nënkryetar i komunës - tha se kontrata mbi veprën ekziston që nga koha antike, dhe ajo gjen zbatim zakonisht kur disa punë apo shërbime nuk mund të kryhen dhe atëherë duhet të lidhet një kontratë e tillë. Pastaj arsyetoi se urgjenca e punëve siç janë ato në lëmin e kulturës dhe atë të shërbimeve publike ka bërë që të lidhen këto kontrata. Në fund ai vlerësoi se parimisht është kundër kontratave mbi vepër, dhe kishte me qenë mirë që ato të ndalohen me ligj të veçantë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se Drejtoria e Kadastrit, duhet ta kompletojë lëndën sa i përket pikës së pestë të rendit të ditës, ashtu që pjesë e propozim-vendimit të mbetet edhe parcela

kadastrale P-70202016-02356-1, më konkretisht bëhet fjalë për pëlqimin e banorëve, pronarë të asaj prone, ku në këtë parcelë, parashihet që investitori të ndërtojë një objekt banesor kolektiv. Andaj shtoi se nëse ka pëlqim të banorëve, nëse ata janë pronarë dhe e kanë të definuar të drejtën e pronësisë, nëse ju dihet pjesa tjetër e bashkëpronësisë, atëherë ai është dakord që kjo pikë të aprovohet ashtu siç është propozuar. Në të kundërtën nëse kjo pikë nuk plotësohet me certifikatën pronësore, kopjen e planit dhe pëlqimin atëherë paragrafi i 1.3 i propozim-vendimit të hiqet nga rendi i ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se e përkrah propozimin që pika lidhur me dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë të futet në rend të ditës, për faktin se banorët e atyre pronave kanë kërkuar që të ndërmerren masa prej komunës lidhur me atë objekt të banimit, sepse një kërkesë e tillë ka qenë edhe në mandatin e kaluar, dhe banorët e atij objekti kanë dhënë pëlqimin përmes akteve noteriale, por tani komuna duhet ta ruaj interesin e përgjithshëm, andaj në këtë rast kërkesat e palëve janë legjitime dhe në këtë rast kjo çështje duhet të shtyhet përpara.

Bahrije Ademi Murati, anëtare e kuvendit - propozoi që pika 1.1 e propozim-vendimit për dhënien afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, që ka të bëjë me stadiumin e gomës të hiqet nga rendi i ditës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se lidhur me stadiumin e gomës, mund të diskutohet dhe të hiqet kjo pikë nga dhënia në shfrytëzim, në momentin kur të vijë radha e shqyrtimit të asaj pike, dhe shtoi se e përkrahin propozimin që ai lokacion mos të jepet në shfrytëzim sepse është i vetmi vend ku rinia mund të zhvillojë aktivitetet e tyre sportive.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - propozoi që ajo pikë e rendit të ditës për dhënin në shfrytëzim afatgjatë të hiqet në tërësi nga rendi i ditës pasi ajo nuk është e përgatitur si duhet.

Në fund të diskutimeve jashtë rendit dhe për rendin e ditës kuvendit pas votimit me vota “unanime” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.12.2018;
2. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit-qeverisë komunale për vitin 2019;
3. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019;
4. Shqyrtimi i Raportit janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale;
7. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i propozim-vendimit për korrigjimin e vendimit të kuvendit 01Nr.292/18 për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve të komunës;
 - b). Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për KEDS-in.
 - c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 27.12.2018

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – kërkoi që në procesverbal të mbledhjes së kuvendit të evidentohen anëtarët e kuvendit që kanë dhënë dorëheqje nga pozita e anëtarit të kuvendit.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 27.12.2018, me vërejtjen e parashtruar nga anëtarit i kuvendit.

2. Shqyrtimi i Draft-planit i punës të Kryetarit-qeverisë komunale për vitin 2019

Gresa Muli, anëtare e kuvendit - propozoi që në kuadër të investimeve kapitale në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, të inkorporohet projekti për ndërtimin e tualeteve publike, afër parqeve dhe shesheve, si dhe vendosja e wi-fi-ve afër parqeve dhe shesheve. Lidhur me këtë vlerësoi se është imediate dhe shumë e nevojshme pasi që Vushtrria nuk ka asnjë tualet publik. Pastaj lidhur me sistemin e furnizimit me ujë të pijshëm ceku se në DSHP duhet të bëhen projektet shtesë për fshatrat që kanë probleme me furnizim me ujë të pijshëm ashtu që të mundësohet instalimi i sistemit të pompimit për furnizim me ujë. Mandej tek Drejtoria e Arsimit nuk është cekur krijimi i këndeve të leximit, si dhe furnizimi me libra për ato kënde të leximit ku ato mungojnë. Gjithashtu ajo kërkoi sqarim për siç tha tek tabela e Drejtorisë së Arsimit nuk është evidentuar projekti nga faqja 3 e planit, lidhur me furnizim me shujta për nxënës. Ky mund të jetë ndonjë gabim teknik, por duhet të përmirësohet. Në Drejtorinë e Urbanizmit tek pika 6 që ka të bëjë me sistemin e menaxhimit të adresave në krejt territorin e komunës në qytet dhe në fshatra, në këtë relacion ajo i propozoi drejtorisë që të ketë interesim sa i përket futjes së adresave të reja në harta, me qëllim që ato adresa të futen në harta të cilat janë të përditësuara në internet, kjo për faktin se ka emra të rrugëve që janë emëruar gati që 5 vite dhe akoma ato rrugë nuk mund të gjinden askund. Tek inspektorati, vlerësoi se është shumë i nevojshëm themelimi i një qendre të thirrjeve për raportimin e shkeljeve në biznese ku ato thirrje do të mbeteshin anonime, për faktin se dihet se sa kemi shkelje në biznese sa i përket sidomos të drejtave të punëtorëve dhe një qendër e tillë do ndihmonte në këtë drejtim. Në Drejtorinë e Administratës vlerësoi se si rezultat i sulmeve kibernetike qoftë ato në institucione private dhe publike, propozoi që të formohen ID-Bekap të përditshëm të të dhënave që janë në administratë për faktin se shumë institucione kanë vuajtur pasojat nga këto sulme kibernetike, nga ikriptimi i të dhënave nga hakerët e ndryshëm. Pastaj në Zyrën për të drejtat e njeriut në shumë dokumente zyrtare përdoret termi femër, e jo termi grua dhe kjo për të është nënçmuese, andaj ky term duhet të zëvendësohet me termin grua sepse termi femër përmban aspektin apo kuptimin tërësisht biologjik që përkufizohet me aftësinë riprodhuese të femrës, qenie kjo që mund të jetë edhe një lule, shpezë apo kafshë andaj pikërisht termi grua e bënë dallimin e përkatësisë sociale dhe njerëzore. Sa i përket çështjeve gjinore ajo propozoi që të punohet më shumë në punë produktive dhe jo në shënimin e ditëve simbolike. Në Drejtorinë e Administratës në ZBGJ të përkrahen projektet që i mbështesin nënat vetushqyese, evidentimi i tyre, mundësimi i vizitave mjekësore psikologjike falas për to dhe për fëmijët e tyre. Në Drejtorinë e Kulturës propozoi që të dhënat për monumentet e trashëgimisë kulturo-historike që datojnë shumë herët të futen në faqet prestigjioze në internet siç është trip adviser, sepse kjo do të mundësonte rritjen e vizitave ndërkombëtare të qytetit të Vushtrrisë.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - kërkoi sqarime lidhur me ndërtimin dhe rritjen e vendparkingjeve publike, si dhe në cilat vende është paraparë ndërtimi i tyre, kurse ceku se vendparkingjet duhet të hapen për qytetarët. Pastaj shtoi se me çfarë projekti është duke u punuar

për këto parkingje pasi siç dihet nuk ka vendparkingje të mjaftueshme për qytetarët. Tutje propozoi që të merret për bazë modeli i Prizrenit sa i përket rregullimit dhe mirëmbajtjes së vendparkingjeve, ku duhet të vendosen kamerat dhe të rritet siguria në vendparkingje. Lidhur me ndërmarrjen e masave për lirim e pronës komunale të uzurpuara, deri më tani nuk ka veprime specifike dhe masa konkrete që janë ndërmarrë nga drejtoria kompetente edhe përkundër faktit se ne jemi në dijeni se në komunën tonë ka një numër të konsiderueshëm të pronave të uzurpuara. Pastaj duke ju referuar faqes 11 të planit shërbimet publike konkretisht tek konkursi për ndarjen e linjave në transportin urbano-periferik të udhëtarëve, reduktimi dhe sistemimi i kombibusëve, si dhe vendosja e tyre në një vendparking, kjo për faktin se kemi një numër të madh të kombibusëve që qarkullojnë e të cilët nuk kanë leje nga komuna, për këtë pyeti se a ka ndonjë plan për funksionalizimin e linjave të rregullta pasi që dihet komuna jonë ka shumë fshatra dhe për të gjitha këto fshatra nuk mund të ketë linja të rregullta të sistemit të linjave të udhëtarëve, si dhe çka do të ndodh me fatin e kombibusëve pasi që ata të hyra primare e kanë punën e transportit me këta kombibusë. A do të mund që komuna të lidh ndonjë kontratë me këto subjekte me qëllim që ata të mund të zhvillojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu ceku se duhet që këtyre kombibusëve t'u caktohet lokacioni në qytet dhe ata të jenë të sistemuar në zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Pastaj ka vërejtur se në Drejtorinë e Urbanizimit mungon stafi i ekspertëve në këtë lëmi, dhe në këtë kontekst nuk di se me çfarë logjike kërkohet shtimi i drejtorive komunale, kur dihet fakti se kemi mungesë të stafit dhe të ekspertëve përkatës, andaj nëse bëhet rritja e numrit të drejtorive komunale, atëherë duhet të bëhet e ditur se rritja po bëhet për t'i kënaqur ambiciet e koalicionit qeverisës apo kjo po bëhet për interesin e qytetarëve. Tek Zyra për të drejtat e njeriut avancimi i të drejtave të femrës, vlerësoi se kjo zyre e ka humbur veprimin, pasi që ajo është bërë e papërfillshme, dhe këtë e arsyetoi me faktin se ka disa muaj që Komiteti për Politikë dhe Financa ka mbetur i paplotësuar kur dihet fakti se ajo pozitë i takon një femre, por ajo nuk po plotësohet dhe roli i Zyrës për barazi gjinore është i padukshëm.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit - kërkoi që të kemi inspektim më të madh nga inspektorati komunal sa i përket kyçjeve në rrjetin e ujësjellësit. Ajo kërkoi që të shtohet një paragraf në plan që ka të bëjë me inspektimin e moskyçjeve të ekonomive familjare në ato vendbanime ku ekziston kolektori kryesor për shkak se ata e ndotin ambientin për faktin se edhe pse ekziston kolektori kryesor ata kanalizimin e qesin në prroska ose në rrugë, andaj kërkoi që kjo të inspektohet nga komuna.

Melihate Basholli - Latifi, anëtare e kuvendit - tha se në këtë plan është mirë që Drejtoria e Kulturës, të renditet më lart tek Drejtoria e Arsimit, pasi që kultura, sporti dhe rinia janë ambasadorët më të mirë të qytetit dhe shtetit. Tutje shtoi se është mirë që pasurimi i bibliotekave qoftë ajo e qytetit apo ato të shkollave të mos jetë vetëm sezonal, siç ndodh gjatë muajve janar, shkurt dhe mars, por kërkoi që pasurimi i këtyre bibliotekave të jetë i planifikuar me buxhet komunal dhe të jenë libra që iu hyn në punë nxënësve, studentëve dhe të gjithë atyre që janë dashamirë të librit. Lidhur me këtë ajo propozoi që të ngritet një komision, i cili do të përbëhet nga zyrtarë të DKRS-së dhe mësimdhënës që do të merren me seleksionimin e librave dhe lektyrave të nevojshme. Në vazhdim ajo duke iu referuar faqes 52 të planit, pyeti drejtoreshën e Drejtorisë së Kulturës, ku në pikën dhjetë thuhet: do të synojmë që të bëjmë digjitalizimin e bibliotekës, dhe ky synim ka qenë edhe në mandatin e kaluar por ja ku jemi sot, për këtë pyeti a ka ndonjë hap konkret apo kjo do të mbetet vetëm si dëshirë.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - paraqiti vërejtje teknike sa i përket planit, për faktin se materiali nuk është i fotokopjuar si duhet. Tek Drejtoria e Bujqësisë fondi me bashkëdonatorë, projektet me bashkëfinancim me donatorë për këtë pyeti se a dihen se cilët do të jenë donatorët.

Shpenzimet e tërësishme në Drejtorinë e Bujqësisë, janë gjithsej 475.000.00 €, por këtu nuk janë të specifikuar shumat për qëllimet e caktuara që do të shpenzohen, përpos shumës prej 100.000€ që është përcaktuar për subvencionimin e kamatës për bizneset e reja. Pastaj pika 8 është në kolezion me pikën 17, pasi që në pikën 8 thuhet që eliminimi i deponive është i paraparë gjatë muajit shkurt dhe mars, ndërsa në pikën 17 planifikimi është 5 vjeçar për tërë vitin. Mandej përgatitja e dokumentacionit për tenderimin e rrugëve me kubëza është planifikuar të bëhet gjatë muajit prill, por kjo është gabim se këto projekte zhvillohen gjatë tërë vitit. Mandej idea e rregullimit të shtratit të lumit “Tërrstena”, nuk e di se çfarë është menduar këtu pasi shtrati i këtij lumi është betonuar nga pushteti i kaluar. Pastaj tek Drejtoria e Arsimit pika 1.7 këtu pyeti se a është fjala për përfundimin e çerdhes së nisur apo mendohet ndërtimi i një çerdheje të re siç thuhet në pikën 1.4. Tek Drejtoria e Urbanizmit mjetet e inkasuara në rastin e lëshimit të lejeve ndërtimore, mjetet e inkasuara nga taksa e dhënies së pronës në shfrytëzim, mjetet nga taksat për leje mjedisore, ato të instalimeve mbi dhe nëntokësore, mjetet që inkasohen nga legalizimi i objekteve, për të gjitha këto a është bërë parallogaria se sa do të jetë totali i këtyre të hyrave.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit - duke iu referuar shërbimeve publike, ceku se rregullimi i shtratit të lumit “Tërrstena”, ka një kosto të lartë financiare, dhe nuk e di çfarë është menduar me mjetet e planifikuara prej 10.000 €. Tutje vlerësoi se duhet të intervenohet në ato pjesë të lumit ku gjendja është më e rëndë si p.sh në fshatin Begaj, si dhe duhet të parandalohen keqbërësit në hedhjen e mbeturinave në lumë ashtu që të mirëmbahet pastërtia e lumit.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit - duke iu referuar faqes 3 të planit, ndërmarrja e masave për lirim të pronave komunale të uzurpuara, publikimi i të gjithë shfrytëzuesve të pronës komunale. Për këtë pyeti se a ka prona të uzurpuara, a dihen këta uzurpator, si dhe cilat janë masat që janë ndërmarrë gjatë kësaj periudhës njëvjeçare për lirim të këtyre pronave. Mandej lidhur me funksionalizimin e parkut industrial, ceku se në vitin 2018 ka qenë e planifikuar që të investohen 400,000 € dhe kjo nuk është bërë, andaj pyeti se deri ku ka shkuar zhvillimi i këtij projekti së paku me dokumentacion, si dhe a ka ndonjë rrezik që këto mjete të humbin apo si qëndron çështja. Pastaj tek Drejtoria e Arsimit nuk është cekur askund emërtimi i shkollave, nuk është bërë planifikimi i emërimit të tyre, dhe ne e dimë që në qytet dhe fshatra kemi shkolla pa emra siç janë SHMU 1, SHMU 2 dhe emërtimi i këtyre shkollave duhet të planifikohet dhe realizohet. Pastaj kërkoi që të bëhet depolitizimi i arsimit dhe qysh ka ndodhur nga e kaluara dhe ashtu siç ka ndodhur vitin e parë të kësaj qeverie ku pjesa më e madhe e drejtorëve të shkollave vinë nga radhët e LDK-së. Në fund tha se është për t’u kritikuar zgjedhja dhe përzgjedhja e drejtorëve në shkollat e mesme dhe ato fillore në Komunën e Vushtrrisë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se dëmi më i madh që i bëhet arsimit është politizimi i tij, dhe vlerësoi se edhe në të kaluarën, por edhe aktualisht në kushte të barabarta dhe duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi, i janë dhënë prioritet simpatizantëve të partisë e cila ka qenë në pushtet. Tutje ai ceku se politizimi i arsimit ndodh nga pushteti qendror dhe vazhdon poshtë dhe kjo është e evidente, por para se dikush ta ofendojë dikë dhe të konfrontohemi njëri me tjetrin është mirë të gjejmë zgjidhje dhe rrugë të bashkëpunimit me qëllim që fushën e arsimit ta avancojmë përpara.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit - tha se Nisma Socialdemokrate është duke punuar në avancimin e arsimit në nivel nacional dhe rezultatet janë pozitive çdo ditë e më shumë.

Fatmire Cecelia, drejtoreshë e DKRS-së - njoftoi se vitin e kaluar janë blerë 528 libra nga to 400 tituj të ri, 244 libra shkencorë nga fusha e mjekësisë, drejtësisë dhe ekonomisë, pa i futur këtu 424 libra që janë dhuruar për Ditën botërore të librit, ku është mbajtur një aktivitet. Në fund

njoftoi se gjatë ditëve të ardhshme do të ketë furnizim me libra të reja, dhe kjo falë një donacioni që ka përfituar Komuna e Vushtrrisë nga një OJQ.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se plani i punës është një dokument me rëndësi, i cili përcakton kornizën e veprimeve të organeve komunale brenda periudhës njëvjeçare. Në vazhdim ai njoftoi se do të fillojë projekti për kyçjet individuale në rrjetin e ujësjellësit si një prej projekteve më madhore për fshatrat e Komunës së Vushtrrisë. Mandej do të ketë projekte të tjera si është studimi i fizibilitetit për ndërtimin e stacionit të autobusëve, studimi i fizibilitetit për ndërtimin e tregut për prodhuesit vendorë, do të kemi fillimin e investimeve në zonën ekonomike që ka qenë i planifikuar vitin e kaluar, por që buxheti është risiguruar në këtë vit dhe po ashtu edhe projekte tjera të rëndësishme në fushën e kulturës dhe në fushën e arsimit, po ashtu edhe në fushën e shërbimeve publike dhe atë të planifikimit hapësinorë. Krejt këto projekte që janë planifikuar në buxhet tani janë të reflektuara në këtë plan të punës. Në fund tha se të gjitha sugjerimet e dhëna nga anëtarët e kuvendit do të merren në shqyrtim dhe nëse janë të planifikuara në buxhet do të inkorporohen në plan.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Planin e punës të kryetarit-qeverisë komunale për vitin 2019.

3. Shqyrtimi i Draft-planit të punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me vota unanime aprovoi Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019.

4. Shqyrtimi i Raportit janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se menaxhimi i financave publike tregon të dhëna të nivelit të ulët të performancës, kjo për faktin se kur shikojmë tabelat e burimeve të financimit shohim se Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2018 ka përfituar donacione në vlerë prej 11,402.00 €, ndërsa krahasuar me këtë qeveria e kaluar ka përfituar donacione si vijon: në vitin 2015 ka pasur donacione 389,87.016 €, në vitin 2016 390.95.011 €, dhe në vitin 2017 26,193.018 €. Në këtë konstelacion ai vlerësoi se është shumë interesant se mëditjet jashtë vendit janë rritur tej mase, ndërsa investimet nga donacionet kanë shënuar ulje në mënyrë drastike gjatë këtij viti të kësaj qeverie, ndërsa qeveria e kaluar me shpenzime minimale ka realizuar të hyra nga donacionet. Shpenzim interesant jo i kënaqshëm është tek furnizimet shëndetësore, përkundër faktit që qeveria përmes grantit specifik ka bërë rritjen e këtyre shpenzimeve me qëllim të përmirësimit të këtyre furnizimeve dhe ngritjes së këtyre shërbimeve shëndetësore për qytetarët, por pavarësisht këtyre kjo qeveri nuk ka arritur të funksionalizojë furnizimet dhe më pak ka ble barna dhe pajisje tjera në vlerë prej 15,956.068 €, d.m.th ka bërë furnizime më pak se sa është menduar dhe kjo ndikon në shërbimet shëndetësore të ofruara për qytetarët. Tek shpenzimet e derivateve shpenzimet pothuajse janë të njëjta është një dallim prej 6,682 € kjo për faktin se në vitin 2018 fatmirësisht ka pasur më pak intervenime në shuarjen e zjarreve për shkak të motit me shi, kurse nuk qëndron prononcimi i drejtorit të shëndetësisë i paraqitur në faqen zyrtare të komunës kinse kanë pasur kursime në derivate në transport, sepse e vërteta është se tani e tutje transporti sa i përket emergjencës në QKMF, ka kaluar në kuadër të shërbimit të spitalit dhe për këtë shkak nuk ka pasur ekspozim të këtyre shpenzimeve dhe si rezultat i kësaj kemi pasur më pak shpenzime. Shpenzimi i parasë publike në javën e fundit të vitit 2018 len vend për diskutim dhe dyshime për

keqpërdorim, sepse vetëm në muajin dhjetor janë kryer transfere afër 2 milionë euro, kurse ditën e fundit të vitit kemi pasur një shpenzim enorm apo ekspozim të pagesave prej 500,000 €. Inkasimi i të hyrave vetanake nuk është në nivelin e planifikuar, kurse grantin qeveritar që komuna e ka pasur në dispozicion, qeveria komunale nuk ka arritur ta shpenzojë në masën e dëshiruar dhe si rrjedhojë kemi suficit buxhetor.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - të nderuar qytetarë të Komunës së Vushtrrisë, për hir të korrektësisë dua ta përgëzoj drejtorin për Buxhet dhe Financa z. Lutfi Gërguri, për periudhën njëvjeçare. Sjellja e tij, përgjigjet në pyetjet e anëtarëve të kuvendit, përgatitja e raporteve financiare, konsideroj se janë model i një udhëheqësi të mirë. Një person i paprekur nga sëmundja shoqërore që quhet “Xheloz” do të thoshte: “Udhëheqja është një tipar të cilin shumica e deklarojnë, por vetëm disa e meritojnë me të vërtetë.” Në tabelën për periudhën raportuese për TË HYRAT VETANAKE NËPËR DREJTORI, kemi mospërputhje: Te inkasimi i të hyrave sipas drejtorive dhe kodit ekonomik (shih tab.1) Tek tabela: PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS BURIMIT TË FINANCIMIT (shih tab.2). Konsideroj se këtë përqindjen 90% e rrit granti qeveritar, edhe pse është shumë mirë që është shpenzuar në masën prej 99%-shit, sepse do të shkonin mjetet në suficit. Shuma e kodit 10 që është 14,95.1916.25 përbën 81% të shumës totale. Por hiç këtë kod dhe llogarit 5 kodet tjera: Buxheti i planifikuar për periudhën janar-dhjetor 2018 është shpenzuar në masën 54%. Tek tabela PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE SIPAS DREJTORIVE pyetja ime për periudhën raportuese është vetëm për dy kode: Tek KODI (180), buxheti i planifikuar ka qenë 3084175.93€, ndërsa janë realizuar shpenzimet në shumën prej 2,333.747.49€ që i bie se buxheti i mbetur për 2018 është 750428.44€. A mund ta sqaroni se cilat projekte kanë mbetur pa u realizuar? Tek KODI (470), buxheti i planifikuar ka qenë 660926.32€, ndërsa janë realizuar shpenzimet në shumën prej 441337.67€ që i bie se buxheti i mbetur për 2018 është 219,589.15€. Pyetja është e njëjta, si ajo paraprake! Tek tabela MALLRAT DHE SHËRBIMET (shih tab.3) Si rezultat i marrjes së veturave me qira, kemi më pak shpenzime për karburante për vetura dhe mirëmbajtje të automjeteve në shumën prej 20850.72€. Pyetja është: A e keni bërë një krahasim, a ka përfituar komuna që i ka marrë me qira automjetet? Dhe krejt në fund tek tabela INVESTIMET KAPITALE (shih tab.4) Sa janë mjetet të bartura dhe në cilat projekte janë bartur mjetet financiare? Nëse mund ta sqaroni për lexuesin që ta kuptojmë!!! Gjithashtu ai pyeti se përse nuk janë realizuar disa projekte kapitale, me theks të posaçëm ato në fshatin Zhilivodë, siç është ndërtimi i kullës në këtë fshat dhe shtrimi një rruge.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - duke iu referuar raportit ceku se kemi një hiper-vlerë të shpenzimeve për udhëtimet jashtë vendit, dhe kjo krahasuar me vitet paraprake. Andaj në këtë kontekst ajo kërkoi që të bëhet përshkallëzimi i këtyre shpenzimeve nëpër drejtoritë dhe zyrat tjera siç është zyra e kryetarit të komunës, si dhe duhet të kemi një arsyetim të bazuar se çka ka përfituar komuna jonë nga këto vizita dhe nga këto shpenzime kaq të mëdha.

Sylejman Mehulli, drejtor i DSHPS-së - paraqiti sqarime duke shtuar se furnizimi me barna është politikë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe atë në nivelin parësor shëndetësor përmes listës esenciale të barnave, të cilat komuna ka të drejtë t’i menaxhojë dhe distribujë dhe komuna furnizon aq sa furnizon Ministria e Shëndetësisë. Ndërsa sa i përket furnizimeve shëndetësore tek kodi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore, kemi realizuar më tepër sesa në vitin 2017, kurse sa i përket kodit për furnizime mjekësore 13630, ka një diferencë që ka më pakë, por kjo arsyetohet sepse është një kontratë dyvjeçare 2018-2019 dhe për shkak të procedurave të prokurimit ka pasur një vonesë derisa është lidhur kontrata e re, në të kundërtën prej momentit të lidhjes së kontratës, por edhe në përgjithësi gjatë gjithë vitit 2018, ka qenë viti më i mirë sa i

përket furnizimit me barna që ka qenë ndonjëherë në QKMF, dhe krejt kjo për shkak të kontrollit strikt që i është bërë nga ana e Drejtorisë së Shëndetësisë. Pastaj punën e furnizimit me barna e ka karakterizuar edhe transparencja, ku në shërbimet e urgjencës është bërë transparentet lista e barnave esenciale që është në stok dhe çdo qytetar e din qartë se cilat barna gjenden në atë listë, pra nuk kemi vendosje selektive të barnave në atë listë, por krejt çka ekziston shërbehet për qytetarët. Sa i përket shpenzimeve të transportit është e vërtetë se ato janë ulur sa i përket derivateve në nivelin parësor shëndetësor dhe atë për 7496 litra, janë vendosur gjipieset në secilën autoambulancë apo veturë për të monitoruar saktë shpenzimin e derivateve. Është e vërtetë që është zhvendosur shërbimi i emergjencës nga spitali në urgjencë dhe është shkurtuar rruga dhe këtu kostoja e shpenzimeve po e arsyeton vendimin që është marrë. Në fund ai tha se qytetarët e kanë kthyer besimin tek strukturat dhe profesionistët shëndetësorë sa i përket shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor dhe kjo argumentohet edhe me rritjen e numrit të shërbimeve shëndetësore të ofruara dhe numrin e pacientëve.

Lutfi Gërguri drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me raportin janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet, duke shtuar se është e vërtetë se kemi më pak të hyra vetanake për 291.000.00 € në krahasim me vitin paraprak, dhe kjo është reflektuar në aspektin e lejeve ndërtimore. Ndërsa sa i përket kategorive tjera të të hyrave vetanake, si nga tatimi në pronë, nga dhënia e pronës në shfrytëzim dhe taksa në firmë, qeveria ka punuar shumë mirë dhe kemi tejkalim të të hyrave krahasuar me qeverinë e kaluar. Pastaj lidhur me shpenzimet në fund të vitit kjo është dukuri që përcillet për çdo vit dhe kjo gjendje ka qenë edhe në qeveritë e kaluara. Pastaj ceku se fakti se nuk janë realizuar të hyrat, ka rezultuar me heqjen e disa projekteve, kurse nga të hyrat e grantit, sa i përket investimeve kapitale kanë mbetur pa u shpenzuar vetëm 69,000.00 €

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - kërkoi të informohet kuvendi lidhur me suficitin e krijuar në kategorinë e pagave, pasi më herët kishte deklarime se si rezultat i mungesës së stafit kishte pasur punësime me kontratë mbi vepër.

Lutfi Gërguri drejtor i DBF-së - njoftoi se si rezultat i mosshpalljes së konkursit për disa pozita, mandej mosrritja e disa koeficientëve për shkak të Ligjit të pagave ka pasur suficit në kategorinë e pagave.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - tha se qeveria dhe drejtorët komunal janë drejtorët më transparent në njëzet vitet e fundit, andaj arsyetimet që ata i dhanë nuk ua heq asnjë fjalë. Tutje ai justifikoi rritjen e shpenzimeve komunale sidomos sa i përket reprezentimit të komunës me qytetet tjera, duke shtuar se Komuna e Vushtrrisë ka lidhur një marrëveshje me shtetin IOWA, dhe si rezultat i bashkëpunimit, njëra nga gazetatat kryesore të shtetit të IOWA, ka publikuar tre artikuj ku është promovuar qyteti i Vushtrrisë. Pastaj si rrjedhojë e këtij bashkëpunimi është mundësuar shkëmbimi i studentëve ku 25 studentë nga IOWA kanë vizituar qytetin tonë, mandej konform këtij bashkëpunimi Vushtrria do të ketë mundësinë e shkëmbimit ekonomik, ku ky shtet zyrtarisht i ka bërë ftesë tri bizneseve të Vushtrrisë që ta shtrijnë veprimtarinë e tyre në shtetin e IOWA. Në këtë kontekst zyrtarisht ky qytet do të ketë një shenjë në SHBA, kurse Vushtrria do ta emërtojë një park me emrin e qytetit të NORWALK, kjo me qëllim që të nderohet miqësia e përhershme që kemi me SHBA-të, dhe për të mbetur në kujtesën kolektive kujtimi për miqësinë reciproke që ka populli shqiptar me popullin amerikan. Në vazhdim ai ceku se udhëtimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, është i kushtueshëm dhe për këtë kemi pasur rritje të shpenzimeve në kategorinë e shpenzimeve jashtë vendit. Në fund tha se shpenzimet do të jenë në nivelin e domosdoshëm për funksionimin e qytetit dhe për promovimin e qytetit gjithandej nëpër botë, por gjithmonë ato do të karakterizohen nga transparencja dhe llogaridhënia.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit – tha se kryetari i komunës është mirë që t'i bëjë transparente dhuratat që i pranon që janë në vlerë mbi 50 €, sepse atë e ka obligim ligjor. Ai shtoi se këtë do ta bëjë edhe grupi kuvendar i PDK-së dhe atëherë do të ketë ballafaqim të fakteve se kush është duke marrë dhurata siç ishte ajo e kryetarit të komunës.

Xhafer Tahiri, kryetar i komunës - përsëriti se çdo dhuratë do të jetë transparente sipas ligjit në Agjencinë Antikorrupsion, sepse janë qeveri ndryshe ku funksionon vetëm në bazë ligjit. Tutje shtoi se është mirë që dikush ka emaila që janë konfidenciale, dhe ato duhet t'i publikojë, pastaj njoftoi se telat e kamerave të qytetit kanë qenë të këputura dhe ato janë rregulluar, por për këtë do të ketë përgjegjësi. Në vazhdim ai njoftoi se është duke u bërë shtimi i kamerave në qytet dhe kjo ndikon në ngritjen e sigurisë së qytetarëve, ku si rezultat i kësaj janë zbuluar disa vepra penale dhe janë kapur kryerësit, kështu që ndër to është zbuluar kryerësi i veprës në objektin afër komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se është për keqardhje qasja e kryetarit të komunës, i cili merret vazhdimisht me qeverinë e kaluar e madje merret edhe me familjet dhe gratë e bartësve të institucioneve që kanë qenë në të kaluarën. Andaj ai i apeloj që mos të etiketon njerëz, mos të merret me të kaluarën sepse ai nuk i ka punët mirë nuk e ka komoditetin, por edhe sikur ta kishte do duhej të merrej me të tashmen dhe interesin e qytetarëve. Pas kësaj ai duke iu referuar deklaratimit të kryetarit të komunës lidhur me pranimin e dhuratave, kërkoi sqarim se a ka pranuar dhurata apo jo sepse ai sikur dëshiron t'i qet në lajthim anëtarët e kuvendit pasi që njëherë deklaroi se nuk ka pranuar dhuratë e mandej tha se të gjitha do t'i deklarojë në Agjencinë Antikorrupsion.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 2 vota “abstenim” aprovoi Raportin janar-dhjetor 2018 për të hyrat dhe shpenzimet.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime hyrëse lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke shtuar se, kuvendi është njoftuar përmes një shkrese përcjellëse, lidhur me një gabim teknik që ka rrjedhur ku është gabuar një numër i parcelës kadastrale, ku në vend të lokacionit ku ndodhet objekti i vjetër, është futur parcela kadastrale ku ndodhet objekti i gjykatës së re, por kjo është përmirësuar dhe propozoi që propozim-vendimi të aprovohet me këtë ndryshim. Andaj nga propozim-vendimi hiqet parcela kadastrale 2358-10, ndërsa inkorporohet në propozim-vendim parcela kadastrale 129-0 me sipërfaqe prej 473 m².

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - tha se nëse ekziston pëlqimi i pronarëve, pasi ai është i prirë të besojë se ekziston ai pëlqim i pronarëve të atyre pronave, atëherë është mirë që ai pëlqim t'i bashkëngjitet këtij propozim-vendimi. Tutje ai propozoi që këto prona të jepen në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit - tha se e mbështesim këtë propozim-vendim, dhe shtoi se e përkrah idenë që këto prona të jepen në shfrytëzim për 99 vite, pasi vetëm kështu mund të kemi investitorë serioz, andaj propozoi që në gjitha pikat e vendimit ku ceket se prona jepet në shfrytëzim për 40 vite të bëhet për 99 vite ashtu që çdo pikë veç e veç të votohet.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - në rekapitullimin e debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës konstatoi se pika 1.1 e propozim-vendimit që ka të bëjë me stadiumin e futbollit hiqet nga propozim-vendimi.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit - tha se grupi kuvendar i LDK-së e përkrah idenë që të hiqet nga propozim-vendimi pika 1.1 që ka të bëjë me dhënien në shfrytëzim të stadiumit, pasi në të do të mund të bëheshin investime nga komuna dhe ai do të përdorej nga sportistët.

Ismet Gashi, udhëheqës i zyrës ligjore - tha se propozimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së komunës për 99 vite për KEDS-in nuk mund të futet në të njëjtën vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, pasi në këtë rast kemi të bëjmë me një formë tjetër të dhënies së pronës në shfrytëzim sipas nenit 10 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe në këtë rast kemi procedurë të veçantë.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 26 vota “për” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë evidentuar në ngastrën kadastrale P-7020216-00001-1, P-7020216-02356-1 dhe P-7020216-00129-0 Zona Kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë.

1.1 Pjesë nga ngastra kadastrale P-7020216-00001-1 në sipërfaqe prej 9100m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 14732m², jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë, për rregullimin e hapësirës sipas Vendimit 58/2016 të dt.20.12.2016 të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

1.2 Ngastra kadastrale P-7020216-02356-1 në sipërfaqe prej 1058 m², jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë për ndërtim të lartë. Komuna do ta ruajë interesin e saj publik përmes kushteve që do t'i përcaktojë në rastin e zhvillimit të procedurave të konkursit publik, kurse pjesën tjetër investitori.

1.3 Ngastra kadastrale P-7020216-00129-0 në sipërfaqe prej 473 m² me objekt, jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite përmes konkursit publik për personat fizikë dhe juridikë.

2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale që të zhvillojë procedurat për shpalljen e konkursit publik, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të konkursit publik.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me nr.01Nr.502/09 të dt.30.07.2009 për dhënien në shfrytëzim me koncesion të pronës komunale, pjesë e parcelës nr.1-1, Zona Kadastrale Vushtrri.

4. Pjesë e këtij vendimi paraprak janë: Certifikatat e pronës, kopjet e planit dhe vendimi i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - kërkoi nga Drejtoria e Kadastrit, që të ketë kujdes kur t'i ofrojë kuvendit pika lidhur me dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim, duke i dhënë sqarimet e nevojshme ashtu që kuvendi të ketë informacione se për çfarë është duke votuar.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, në ngastrat kadastrale P-70202028-00032-0, P-70202028-00031-0, P-70202028-00015-0, P-70202028-00014-1, P-70202028-00412-4, Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, P-70202041-01429-0, P-70202041-01436-0, Zona Kadastrale Mihaliq, P-70202017-00459-0, Zona Kadastrale Gllavotin dhe P-70202062-00106K-0, Zona Kadastrale Qytezë.

1.1. Parcela kadastrale P-70202028-00032-0 në sipërfaqe prej 3356m², P-70202028-00031-0 me sipërfaqe prej 3246 m², P-70202028-00015-0 me sipërfaqe prej 2675m² dhe P-70202028-00014-1 me sipërfaqe prej 10747 m², Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.

1.2. Pjesë nga parcela kadastrale P-70202028-00412-4 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 6211 m², Zona Kadastrale Stanovc i Poshtëm jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.

1.3. Parcela kadastrale P-70202041-01429-0 në sipërfaqe prej 68675 m² dhe P-70202041-01436-0 me sipërfaqe prej 77864 m², Zona Kadastrale Mihaliq, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.

1.4. Pjesë nga parcela kadastrale P-70202017-00459-0 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 37286 m², Zona Kadastrale Gllavotin, jepen në shfrytëzim afatshkurtër për 10 vite, përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari bujqësore.

1.5. Parcela kadastrale P-70202062-00106K-0 me sipërfaqe prej 1298m², Zona Kadastrale Qytezë jepet në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite përmes konkursit publik-ankandit për persona fizikë dhe juridikë për veprimtari afariste.

2. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale që të zhvillojë procedurat për shpalljen e ankandit, si dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë

që të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e të gjitha kontratave pas lidhjes së tyre.

7. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i propozim-vendimit për korigjimin e vendimit të kuvendit 01Nr.292/18 për shpalljen e ankandit publik për shitjen e automjeteve të komunës

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim bëhet korigjimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë me Nr.292/18 i datës 25.10.2018, lidhur me shpalljen e ankandit publik për shitjen e mjeteve motorike të autoparkut të Komunës së Vushtrrisë si në vijim:

1.1 Në pikën 1.2 të vendimit të sipërcekur, korigjohet gabimi teknik dhe bëhet pika 1.2.

1.2 Pika 1.3 e vendimit hiqet, pasi e njëjta është përsëritur në pikën 1.4, ku është përsëritur mjete i njëjtë motorik me numrin e njëjtë të tabelave.

1.3 Në pikën 1.5 në vend të mjetit motorik TOYOTA RUNER me numër të tabelave 531-KS-065, i cili nuk i nënshtrohet ankandit publik, vendoset në ankand publik mjete motorik RENO CLIO, me numër të tabelave 02Z-03-27.

2. Pjesët tjera të këtij vendimi mbesin të pandryshuara dhe mund të prodhojnë efekt juridik.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtorja e Prokurimit, si dhe Drejtorja për Shërbime Publike.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Në vazhdim kuvendi duke u bazuar në nenin 47 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me 25 vota për, 1 votë abstenim, vendosi që ta inkorporojë në rend dite propozim-vendimin e poshtëshënuar:

b). Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, për KEDS-in

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, në lokacionin si në vijim:

1.1 Vendorsja e një Stabilimenti shpërndarës me një transformator në parcelën kadastrale me Nr. P-70202010-00081-0 Z.K Bukosh, pronë e Komunës së Vushtrrisë me dimensione prej 2.5m'x9m' (22.5m²) e cila përfshin një sipërfaqe të përgjithshme prej 1451m².

2. Ngastra kadastrale e cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite KEDS-it për vendosjen e një Stabilimenti shpërndarës me një transformator pa kompensim.

3. Me zbatimin e planeve rregulluese urbane nga komuna obligohen: Institucioni, kompania kompetente që të bëjë dislokimin e stabilimenteve shpërndarëse (blindë) me mjetet e saj përcjellëse, ashtu siç kërkohet nga organi kompetent.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

5. Pjesë e këtij vendimi janë: Certifikata për të drejtën e pronësisë, kopja e planit.

6. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

c). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit - adresoi shqetësimin e qytetarëve lidhur me urën në fshatin Pestovë, ku kërkoi të informohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për siç tha rrezikun që paraqet kjo urë. Pastaj pyeti se sa po kontrollohen kompanitë kur zhvillojnë punimet në rrugë, pasi ato e prejnë asfaltin, dhe punimet nuk i përfundojnë brenda afateve në ç' rast shumë vetura po dëmtohen si rezultat i kësaj. Por edhe e kundërta e kësaj vendosja e barrierave në rrugë a po bëhet sipas kriterit apo varësisht se si iu konvenon qytetarëve, duke i vendosur ato para shtëpive të tyre.


Sadat Rashica, drejtor i DSHP-së - paraqiti sqarime në pyetjen e anëtares së kuvendit, duke shtuar se ekipet e tyre kanë dalë në terren për verifikimin e gjendjes së urës në Pestovë, për këtë kanë filluar procedurat në Drejtorinë e Prokurimit për renovimin e asaj ure, gjendja nuk është e mirë por nuk është alarmante, andaj pas përfundimit të këtyre procedurave mendon se ky projekt do të përfundojë shumë shpejt. Lidhur me barrierat e vendosura në rrugë ceku se ato vendosen në bazë të kërkesave të qytetarëve, por duke respektuar normat teknike. Lidhur me gropat në rrugë, por edhe ato nga prerja e asfaltit, njoftoi se në to kanë ndikuar edhe kushtet klimatike ku kanë bërë që ato të thellohen, por me përmirësimin e motit ato do të fillojnë të riparohen.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit - kërkoi nga kryesuesi i kuvendit, që t'i shikojë të gjitha vendimet e marra që nga data 1 janar 2018, e deri më tani për faktin se kemi komisione komunale, anëtarë të kuvendit që janë dorëhequr, por edhe zyrtarë që tani nuk janë në marrëdhënie pune në komunë, andaj ato komisione duhet të ndryshohen me anëtarë të ri. Por ka

edhe disa vendime të kuvendit, të cilat janë kthyer si kundërligjore nga Ministria e Pushtetit Lokal, e të cilat kuvendi duhet t'i rishqyrtojë.

Mbledhja përfundoi në ora 13:45.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

